



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:014284

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523528

PKR.nr.78/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga Kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Nushe Kuka Mekaj dhe gjyqtarët profesionistë Ilda Cucoviq Sahatçiu dhe Arben M.j, anëtarë të trupit gjykues, me zyrtares ligjore Zelfije Prekaj, në çështjen penale kundër të pandehurit B. G., për shkak të veprës penale *Krim i Organizuar nga neni 274 par.2 të KPPK-së*, veprës penale *keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi 236 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 5 të KPRK-së*, (pika I, VIII, X, XVI), sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale, nën shenjë PPS.nr.129/14, të datës 16.09.2016, e precizuar për herë të fundit me datë 16.12.2016 dhe me datë 19.06.2017, pas mbajtjes së seancës shqyrtimit gjyqësor të përfunduar me datë 25.03.2024, në prezencë të Prokurorit të Prokurorisë Speciale Burim Qerkini, të pandehurit G. dhe mbrojtësit të tij av.Mustafë Musa, të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 29.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B. G.**, i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt. në, me vend banim në, me numër personal, i martuar baba i 2 fëmijëve, me profesion ndërtimtar, tani i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

Në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së.

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

I. Gjatë periudhës kohore nga muaji Qershor I vitit 2008 e deri në muajin Shtator të vitit 2011, me dashje e dijeni, me qëllim që ky grup të kryej vepra penale të rënda, të pandehurit e lartcekur aktivisht kanë marrë pjesë në aktivitete kriminale të grupit duke e ditur se pjesëmarrja e tyre do të kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda, ku duke vepruar si pjesë e grupit të organizuar dhe si bashkim i strukturave, për të përfituar drejtpërsëdrejti apo tërthorazi çfarëdo dobie pasurore e financuar, nga aktivitetet e prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktuese komuna e Gjilanit me seli në Gjilan, në atë mënyrë që tani i pandehuri Q.M. duke vepruar si person zyrtar, në cilësi të Kryetarit të komunës së Gjilanit njehrit ZKA-së dhe H. D. duke vepruar si person zyrtar në cilësi të menaxheres së zyrës së prokurimit në Komunën e Gjilanit dhe në një aktivitet prokurimit edhe si anëtare e komisionit vlerësues, ndërsa tani të pandehurit Q. S., I.R., M.K., H.M., F.H., D.B., A.H., R.M., S.Sh., G.K., Sh.Q., M.C.Sh., V. G., B.M., H. I., F.O., H.A., S.Xh.,

Q.L., N.S., Z.F. dhe A.M., duke vepruar si persona zyrtar në kuadër të Komunës së Gjilanit, ndërsa tani të pandehurit I.F. dhe M.N. si pjesëtarë të komunitetit më saktë, që të gjithë në cilësi të anëtarëve të komisioneve vlerësuese në aktivitete të ndryshme të prokurimit në këtë komunë, kurse E.B., A.H., A.M. duke vepruar si persona zyrtar në kuadër të Komunës së Gjilanit, më saktë në cilësi të anëtarëve të komisioneve për implementimin e kontratës nr. 1949 e vitit 2010 dhe kontratës nr. 16-1737 e vitit 2011, dhe i pandehuri N.J. duke vepruar si person zyrtar në cilësi të këshilltarit/zyrtarit pranë zyrës për partneritet publiko privat në Komunën e Gjilanit, ku të gjithë të lartcekurit, gjithnjë me qëllim të shkakimit të dëmit për buxhetin e Komunës së Gjilanit apo përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për të operatorët ekonomik: “.....” me pronar tani të pandehurin B.K. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin A. P. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin F.Z. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin S. I. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin N.M. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin M.A. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin B. G. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, “.....” me pronar tani të pandehurin Rr. H. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE, bartës i konzorciumit “.....” me përfaqësues tani të pandehurin A.A. në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE dhe bartës i konzorcionit “.....” me përfaqësues tani të pandehurin Asllan Syka në cilësi të personit përgjegjës në këtë OE , me dashje direkt kanë shpërdorur pozitën e tyre zyrtare dhe autorizimet duke i tejkaluar kompetencat e tyre ose duke mos përmbushur detyrat zyrtare të tyre, në atë mënyrë që tani i pandehuri Q.M. si Kryetar i Komunës (ZKA), ka ndërhyrë duke përcaktuar fitues në aktivitete të ndryshme të prokurimit (tender të ndryshëm) të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, ku përmes kontakteve të drejtpërdrejta dhe komunikimeve telefonike (SMS) i ka dhënë udhëzime dhe instruksione menaxheres së prokurimit tani të pandehurës H.D., duke koordinuar dhe bashkërenduar veprimet lidhur me procedurat tenderuese dhe shpalljen e Operatorëve Ekonomik të caktuar fitues apo anulimin e atyre procedurave tenderuese, për më tepër tani i pandehuri Q.M. duke i tejkaluar kompetencat e tij, në mënyrë arbitrare pa respektuar procedurat e prokurimit siç kërkohet konform ligji të prokurimit publik, me saktë neni 2 dhe neni 117, pika C, të Ligjit për prokurim publik në Kosovë Nr. 2003/17, i kishte dhënë unë OE “.....”, me pronar tani të pandehurin B.K. si te rasti “Rrugët e treta” në shumë prej 787.000.000 €, i pandehuri Q. ngjashëm kishte vepruar edhe në rastin e një aktiviteti tjetër të prokurimit ku ishte paraparë ndërtimi i rreth rrotullimit para gjykatës në Gjilan, fituesi i atij projekti nuk i kishte përfunduar punimet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë ku më pas i pandehuri Q.M. ishte koordinuar me tani të pandehurin A.P. për vazhdimin e punimeve për këtë projekt dhe i njëjti për këto punë ishte paguar rreth 34.869.80 €, në emër të tenderit tjetër me titull “Mirëmbajtja verore e rrugëve”, e krejt këtë tani i pandehuri Q.M. edhe pas kontratave të drejtpërdrejta dhe komunikimeve telefonike me pronaret apo përfaqësuesit e Operatorëve Ekonomik pra tani të pandehurit e lartcekur, të cilët duke vepruar si pronar apo përfaqësues të këtyre operatorëve ekonomik me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për operatorin ekonomik tjetër, me rastin e ofrimit të kompanisë në aktivitete të prokurimit, fillimisht kontraktin Kryetarin e Komunës pra tani të pandehurin Q. M., e në disa raste edhe drejtpërdrejtë menaxheren prokurimit tani të pandehurën H. D. dhe më pas këta pronar apo përfaqësues të këtyre operatorëve ekonomik koordinoheshin në mes veti, se cili nga ta do të shpallet fitues në tenderin e caktuar, kështu duke i kurdisur aktivitetet e prokurimit për shpalljen e Operatorit Ekonomik fitues mirëpo gjithë kjo realizohej në tenderë të caktuar përmes anëtarëve të komisioneve për vlerësimin e ofertave, të caktuara me vendim nga Kryetari i Komunës dhe menaxherja e prokurimit, pra tani të pandehurit Q. dhe H., e të cilët anëtarë të këtyre komisioneve vlerësues, me rastin e vlerësimit të ofertave të atyre Operatorëve Ekonomik, i rekomandonin menaxheres së prokurimit për Operatorin Ekonomik të caktuar, gjithnjë duke vepruar sipas kërkesës së

menaxheres së prokurimit tani të pandehurës H., ndërsa anëtarët përgjegjës për implementimin e kontratës nr. 1949 e vitit 2010 dhe kontrata nr. 16-1737 e vitit 2011, kanë bërë pranimin e punëve në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratat e lartcekura, e krejt këtë ngase të gjithë këta anëtarë të komisioneve për punën e tyre në komisione kompensoheshin nga Komuna e Gjilanit bazuar në vendimet të kundërligjshme me të cilat fillon ky aktivitet kriminal, me saktë vendimi: 01.Nr. 5466 të datës 05.06.2008, vendimi 01.Nr. 5465 të datës 05.06.2008 dhe vendimi 01.Nr. 5466 të datës 05.06.2008, të nënshkruara nga tani i pandehuri Q.M. në cilësi të Kryetarit të Komunës së Gjilanit vendime këto të marra në kundërshtim me Ligjin Nr. 02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, me saktë me Nenin 7, në kundërshtim me udhëzimin administrativ Nr. 03/2010/KRPP, ligji për Vetëqeverisje Lokale me nr. 03/L-040, më saktë me nenin 58 pika k) të këshilltarit/zyrtarit pranë zyrës për partneritet publiko privat në Komunën e Gjilanit, zyrës së prokurimit i dorëzon dokument të rrejshëm në formë të emalit në gjuhën angleze se kinse në bazë të këtij dokumenti mund të vazhdohet tutje për dy nga aktivitetet e prokurimit që ishin duke u zhvilluar pranë kësaj Komune në formë partneritetit të kurdisjes së aktiviteteve të prokurimit të shpallura nga Komuna e Gjilanit i kanë shkaktuar dëm komunës së Gjilanit dhe buxhetit të Kosovës, dëme të cilat tejkalojnë shumën mbi 5.000 euro dhe njëherit përfitim të kundërligjshëm operatorëve ekonomik të caktuar të cilët kishin përfituar nga shumat e këtyre kontratave të cekura veç e veç në secilën pikë të dispozitivit të kësaj aktakuze, ku të pandehurit e lartcekur varësisht nga roli i tyre, me pëlqimin e njëri – tjetrit përmes kurdisjeve kanë kontribuar në këtë aktivitet kriminal i cili më në detaje do të përshkruhet s më poshtë,

VIII. Nga data 01.07.2010 e deri më datën 03.08.2010 ku zhvillohet komunikimi përmes SMS-ve ndërmjet tani të pandehurës H. D. si person zyrtar, në cilësi të menaxheres së zyrës së prokurimit dhe tani të pandehurit B. G. në cilësi të personit përgjegjës të operatorit ekonomik “.....”, komunikime këto të zhvilluara në kundërshtim me Nenin 53 të Ligjit Nr. 2003/17 i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/20, të realizuara ndërmjet të pandehurve të lartcekur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i trotuareve dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me MPMS dhe DPP” me numër të Prokurimit GI 651-10-086-521, të organizuara nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit, në atë mënyrë që të pandehurit e lartcekur, duke vepruar me dashje direkt si grup kriminal i organizuar, e ky aktivitet i prokurimit \, në t cilin kishte ofertuar edhe Operatori Ekonomik “.....” me pronar tani të pandehurin B. G., i cili ishte shpallur fitues nga AK Komuna e Gjilanit në këtë aktivitet tenderues, në atë mënyrë që i pandehuri B. G. kishte pranuar që të pandehurës H. D. ia kishte referuar përmes SMS-it, më saktë, vajzën dhe dhëndrin e saj si dhe një person tjetër, krejt kjo duke vepruar me dashje dhe në kundërshtim me Nenin 117 të Ligjit 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/20 si dhe neni 3 të Kodit Etik të Prokurimit.

X. Nga data 18.02.2010 kur fillon komunikimi përmes SMS-ve për të këtë aktivitet të prokurimit ndërmjet të tani të pandehurit Q. M. si person zyrtar në cilësi të kryetari të komunës së Gjilanit, njëherit edhe zyrtar kryesor administrativ, të pandehurës H. D. si person zyrtar në cilësi të menaxheres së prokurimit rrjedhimisht filtri i fundit në aktivitete të prokurimit, personave përgjegjës të operatorëve ekonomik tani të pandehurit B. G. për OE “.....”, A.P. për OE “.....”, F.Z. për OE “.....”, dhe B.K. për OE “.....” deri me dt. 17.03.2010, me rastin e nënshkrimit të kontratës 02.Nr.32.03, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Asfaltimi i rrugëve ne lagjen Zabeli i Sail Agës” me numër të Prokurimit GI 651-10-016-521, të organizuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjilani, në atë mënyrë që të pandehurit e lartcekur duke vepruar

me dashje direkt si pjesë e grupit të organizuar dhe si bashkim i strukturuar, për të përfituar drejtpërdrejt apo tërthorazi çfarëdo dobie pasurore apo financiare, për vete apo tjetrin, te ky aktivitet i prokurimit, ne dosjen e tenderit e cila ishte dorëzuar nga AK KK Gjilan tek Operatori ekonomik, ishte përcaktuar si kriter tenderi ekonomikisht e i favorshëm, raporti i komisionit vlerësues të datës 23.02.2010 me tani të pandehurit Z.F. , A.M. dhe A.M., si persona zyrtar në cilësi të anëtarëve të komisionit vlerësues të ofertave, rezulton se kriter i zbatueshëm në këtë aktivitet të prokurimit me rastin e vlerësimit kishte qenë çmimi ekonomikisht me i favorshëm, kriter ky që nuk e njeh legjislacionin në fuqi në fushën e prokurimit në përputhje me Nenin 50.1 dhe nenit 50.2 si dhe nenit 58.2 të Ligjit Nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/20, pra komisioni vlerësues në vend se të përmbahet kriterit të përcaktuar si më lartë, kishte devijuar qëllimisht nga ky vend dhe kishte vlerësuar operatorët ekonomik ofertues me kriterin sipas çmimit ekonomikisht me të favorshëm, po ashtu me rastin e vlerësimit të operatorit ekonomik “A.M.”, ky komision vlerësues, me të pandehurin e lartcekur, ofertën e këtij operatori e kishte trajtuar si papërgjegjshme, kinse i njëjti nuk i kishte plotësuar kushtet administrative, por nga shkresat e lëndës rezulton se ky komision vlerësues kishte vepruar në kundërshtim me gjendjen faktike të ofertës së këtij operatori, duke e diskriminuar këtë operator ekonomik në kundërshtim me Neni 6 të Ligjit Nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/20, edhe pse i njëjti kishte qenë me çmimin me të lirë në këtë aktivitet të prokurimit, kurse oferta e operatorit ekonomik “.....” me pronar A.P. në cilësi të personit përgjegjës në këtë operator ekonomik, ishte favorizuar nga ky komision vlerësues me rastin e vlerësimit të ofertave duke trajtuar si ofertë të përgjegjshme, përkundër faktit se nuk kishte validitet të ofertës ky OE në pajtim me nenin 19, pjesë B të rregullores së prokurimit publik, e që kusht ligjor për një proces të rregullt dhe të ligjshëm të prokurimit, ku përfundimisht përkundër shkeljeve të lartcekura ligjore, operatori ekonomik “.....” me pronar të pandehurin A.P. në cilësinë e personit përgjegjës të këtij operatori ekonomik ka përfituar kundërligjshëm me lidhjen e kontratës 02.Nr.3203 të datës 17.03.2010 me çmimin final prej 304.464.39 €, në t cilën shumë është shtuar edhe shuma prej 7.348.09 €, në emër të pagesës së anëtarëve për punën në komisione, pagesë kjo e bërë në kundërshtim me Ligjin Nr. 02/L-133 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, me saktë me Nenin 7 dhe me udhëzimin administrativë Nr. 03/2010/KRPP, krejt kjo as kurdisjeve të më hershme përmes komunikimeve me SMS, komunikime këto të zhvilluara në kundërshtim me Nenin 53 të Ligjit Nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/20, të realizuara ndrmjet të pandehurve Q.M. si person zyrtar në cilësi të kryetarit të komunës së Gjilanit njëherit edhe zyrtarit kryesor administrative, të pandehurës H. D. si person zyrtar në cilësi të menaxheres së prokurimit rrjedhimisht filtri i fundit në aktivitet të prokurimit, personave përgjegjës të operatorëve ekonomik tani të pandehurit B. G. për OE “.....”, A.P. për OE “.....”, F.Z. për OE “.....” dhe B.K. për OE “.....”, që rezulton se në bazë të komunikimeve me SMS, për këtë tender ishin dakorduar që OE “.....” me pronar tani të pandehurin A.P. të shpërblehet me kontratë për këtë aktivitet të prokurimit.

XVI. Me datë 01.11.2010, tani i pandehuri Q. M. si person zyrtar në cilësinë e kryetarit të komunës së Gjilanit, rrjedhimisht zyrtarit kryesor administrativ në këtë komunë, lidh marrëveshje të kundërligjshme me operatorët ekonomik, OE “.....” pronar i së cilës është tani i pandehuri F.Z. si person përgjegjës në këtë operator ekonomik, operatorin ekonomik OE “.....” pronar i së cilës është tani i pandehuri B. G. si person përgjegjës në këtë operator ekonomik, si dhe me OE “.....” pronar i së cilës është tani i pandehuri A.P. si person përgjegjës në këtë operator ekonomik, në atë mënyrë që të pandehurit e lartcekur duke vepruar me dashje direkt si grup kriminal i organizuar, lidhin marrëveshje në emër të huazimit për komunën e Gjilanit në shumë

prej 35.100.00 € nga e cila marrëveshje rrjedh obligimi që secili nga operatorët ekonomik të lartcekur t'i huazojnë komunës së Gjilanit shumën prej 11.700.00 €, e krejt kjo në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, Neni 49 pika 1 të cilat mjete tani i pandehuri Q. M. i shpërndan departamenteve brenda komunës, si dhe personave të ndryshëm fizik dhe juridik, klubeve sportive, krejt kjo në kundërshtim me Nenin 16.3, 17.1 dhe 17.2 të këtij Ligji, ndërsa me datë 22.11.2010 i pandehuri Q.M. në cilësinë e kryetarit të komunës nxjerr Vendimin Nr. 2030/10 me të cilin operatorëve ekonomik të lartcekur, ua kthen huan në shumë prej 35.100.00 €, krejt kjo në kundërshtim me Nenin 17.1 të këtij ligji, vendim të cilin e zbaton S.Xh. si person zyrtar në cilësinë e drejtorit të drejtorisë për rini, kulturë dhe sport në kuadër të komunës së Gjilanit duke vepruar në kundërshtim me Nenin 17.1 dhe 17.2 të po këtij ligji.

Për shkak se Prokurori i Prokurorisë Speciale, është tërhequr nga aktakuza.

E dëmtuara Komuna e Gjilanit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të buxhetit të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Historiku i rastit.

Prokuroria Speciale e Kosovës, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PPS.nr.129/14, të datës 16.09.2016, ndaj të akuzuarve Q. M., H.D., V. G., Q. S. L., I.R., M.N., H.M., M.K., F.H., D.B.K., A.H., R.M., S. M. Sh. , G.K., Sh.Q., M.C.Sh., B. G., I.F., H.I., B.M., F.O., H.A., S.Xh., Q.L., E.B., A.M. , N.S., Z.F. , A.M., N.J. , për shkak të veprës penale *Krim i Organizuar nga neni 274 par.2 të KPPK-së*, lidhur me veprën penale *Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së*, ndërsa të pandehurit B.K. , A.P., Rr. H. , F.Z., S.I., N.M. , M.A., B. G., A.A., A.S., për shkak të veprës penale *Krim i Organizuar nga neni 274 par.2 të KPPK-së*, lidhur me veprën penale *Keqërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.2 lidhur me par.1 nënpar.5 të KPPK-së*.

Lënda në punë është pranuar me datë 21.01.2021.

Me rastin e pranimit të lëndës është vërejtur se ndaj të pandehurit B. G., veçuar procedura nga gjyqtari paraprak bartës i lëndës me aktvendimin nga procesverbali P.nr. 227/16 i dt. 17.10.2019.

Procedura ka vazhduar në raport me të pandehurit tjerë, e të cilët sipas aktgjykimit të formës së prerë nën shenjën P.nr. 227/16 dt. 13.07.2022, janë liruar nga aktakuza.

Në muajin janar të vitit 2024, mbrojtësi i të pandehurit B. G. av. Mustafë Musa, me parashtrësë ka kërkuar nga gjykata që të caktoj shqyrtimin gjyqësor, pasi gjendja shëndetësore e të njëjtit është përmirësuar dhe është i gatshëm të jetë prezentë në seancë.

Në këtë rast gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, e cila ka përfunduar me datë 25.03.2024, në të cilën seancë pasi është deklaruar i pandehuri për fajësinë, prokurori i

prokurorisë speciale Burim Qerkini, ka deklaruar se i pandehuri B. G., ka qenë i përfshirë në aktakuzën PPS.nr. 129/14 së bashku me 38 të akuzuar të tjerë, dhe atë në numrin rendor 33, ndaj të njëjtit është veçuar procedura, ndërsa sa i përket pjesës tjetër ka përfunduar shqyrtimit gjyqësor me aktgjykim të Gjykatës Themelore Pejë nr. P.nr. 227/16 dt. 13.07.2022, i cili aktgjykim është pasuar me një aktgjykim të gjykatës së Apelit APS.nr. 44/22 dt. 15.09.2023, në bazë të cilit është vërtetuar Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e që rrjedhimisht të gjithë të pandehurit tjerë që kanë qenë përfshirë në aktakuzën e cekur më lartë, në mungesë të provave janë liruar nga akuza. I pandehuri B. G. ka qenë pjesë e asaj aktakuzës, veprat penale për të cilat është dyshuar edhe akuzuar kanë qenë në bashkëkryerje dhe si pjesë e grupit me të pandehurit tjerë.

Konform nenit 51 të KPPRK-së, ndaj të pandehurit B. G., është tërhequr nga ndjekja penale, duke shtuar se marrë për bazë gjithmonë që kjo çështje penale është shtjelluar dhe gjykuar, në të cilën çështje kane qenë të përfshira edhe veprimet e tani të pandehurit B. G.. Në këtë rast vjen në shprehje parimi *Beneficium Cohesionis*, ku në rast se kemi çështje të përfunduar për disa të akuzuar për të njëjtën veprë penale, do të veprohet njëjtë edhe për të pandehurit tjerë.

Meqenëse prokurori i prokurorisë speciale është tërheq nga ndjekja penale dhe aktakuza në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi me të cilin e dëmtuara Komuna e Gjilanit, është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë në aplikim të nenit 462 par.2 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilin shpenzimet procedurale do të bien në buxhet të Gjykatës, është marrë konform dispozitës së nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Bazuar në të lartcekurat në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.78/19

Zyrtare ligjore
Zelfije Prekaj

Kryetarja e trupit gjyqësor
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:014284
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523528